



Laboratori i Debatit Universitar
Paketa Kërkimore EDICIONI 4

PAKETA KËRKIMORE-EDICIONI IV

Në kuadrin e projektit “Laboratori i Debatit Universitar: Edicioni IV - Nga fjala tek veprimi” me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë:

Qëllimi i këtij dokumenti është t’u ofrojë studentëve pjesëmarrës një pikënisje kërkimore për përgatitjen e tyre për debatin universitar për integrimin. Më poshtë gjenden 9 temat e debatit nga të cilat studentët do të debatojnë vetëm për njërën në bazë shorti.

Për secilën temë paraqiten disa argumenta kryesorë pro dhe kundra si një bazë fillestare analize mbi të cilën studentët duhet të ndërtojnë argumentat e tyre. Më tej temat shoqërohen me disa burime referuese.

Këto janë vetëm skicime, studentët ftohen të kërkojnë më tej dhe të thellojnë analizën e tyre. Studentët inkurajohen që të përdorin të gjithë aftësitë e tyre kërkimore për tu përgatitur për tematikat e debatit.

Ky dokument duhet të lexohet së bashku me Paketën Udhëzuese të Debatit.

Studentët duhet të ndjekin me kujdes trajnimin për tematikat dhe formatin e debatit dhe të qendrojnë në kontakt me koordinatorin në rank Fakulteti/Universiteti për mbështetje të mëtejshme.

TEMAT E DEBATIT


Debati mes skuadrave

1. Votimi në Shqipëri duhet të bëhet vetëm në mënyrë elektronike.
2. Universitetet publike duhet të jenë falas për të gjithë studentët.
3. Taksimi i sheshtë është model më i përshtatshëm se ai progresiv për kontekstin shqiptar.
4. Digjitalizimi i sektorit publik do të ulë nivelin e korrupsionit në vend.
5. Përdorimi i inteligjencës artificiale për shkrimin e artikujve shkencorë duhet të konsiderohet plagjiaturë.
6. Binjakëzimet mes universiteteve shqiptare dhe atyre evropiane do të ulin trendin e largimit të të rinjve nga vendi.

Debati mes liderve

1. Shqipëria duhet të investojë në lidhjet me diasporën dhe jo në politika për reduktimin e emigracionit në vend.
2. Universitetet shqiptare duhet të favorizojnë në renditje aplikantët e angazhuar në veprimtari vullnetare/komunitare.
3. Lëvizja e lirë në Bashkimin Europian për të jetuar, për t'u arsimuar dhe për të punuar do të shkaktojë krizë demografike në Shqipëri.

Temat e debatit mes skuadrave



Debati mes skuadrave

1. Votimi në Shqipëri duhet të bëhet vetëm në mënyrë elektronike.
2. Universitetet publike duhet të jenë falas për të gjithë studentët.
3. Taksimi i sheshtë është model më i përshtatshëm se ai progresiv për kontekstin shqiptar.
4. Digjitalizimi i sektorit publik do të ulë nivelin e korrupsionit në vend.
5. Përdorimi i inteligjencës artificiale për shkrimin e artikujve shkencorë duhet të konsiderohet plagjiaturë.
6. Binjakëzimet mes universiteteve shqiptare dhe atyre evropiane do të ulin trendin e largimit të të rinjve nga vendi.

VOTIMI NË SHQIPËRI DUHET TË BËHET VETËM NË MËNYRË ELEKTRONIKE.

Pak kontekst: Votimi në Shqipëri zhvillohet manualisht me fletë tip të pajisura me elementë sigurie. Në vitin 2021 KQZ testoi për herë të parë votimin dhe numërimin elektronik në njësinë 10 në Tiranë, dhe në zgjedhjet e pjesshme vendore në Bashkinë e Vorës. Teza e mësipërme propozon që votimi elektronik duhet të zëvendësojë plotësisht votimin manual dhe të shtrihet në të gjithë vendin.

PRO

- Aplikimi i votimit dhe numërimit elektronik nxjerr në kohë reale rezultatin e votimeve.
- Numërimi elektronik eleminon nevojën për numërues, gjë që ul në shpenzimet zgjedhore për burime njerëzore.
- Votimi elektronik minimizon riskun e manipulimeve zgjedhore si votimi familjar, manipulimi i fletëve të votimit, gjë që ndikon pozitivisht në rritjen e besueshmërisë ndaj procesit zgjedhor.

KUNDËR

- Pajisja e gjithë vendit me pajisje të votimit dhe numërimit elektronik ka kosto shumë të lartë monetare.
- Software i pajisjeve të votimit elektronik mund të bie pre e sulmeve kibernetike, gjë që mund ta bllokojë procesin dhe të vendosë në risk për vjedhje të dhënash votuesit.
- Në rast të defekteve teknike me pajisjet e votimit elektronik, numërimi i votave mund të bëhet i pamundur, duke bërë që qeveritë të detyrohen të ribëjnë zgjedhjet.

BURIME

- <https://kqz.gov.al/document/vendim-nr-04-date-13-11-2020-per-llojin-dhe-karakteristikat-teknike-qe-duhet-te-plotesojne-sistemet-dhe-pajisjet-e-votimit-dhe-numerimit-elektronik-qe-prokurohen-dhe-perdoren-ne-zgjedhje-n/>
- 2.3.pdf (ndi.org)
- FINAL_Electronic_Voting.pdf (amazonaws.com)
- Electronic Voting - Arguments Against (stanford.edu)
- Secure Electronic Voting - Dimitris A. Gritzalis - Google Books
- Analysis of an electronic voting system | IEEE Conference Publication | IEEE Xplore
- Introducing Electronic Voting: Essential Considerations | International IDEA

UNIVERSITETET PUBLIKE DUHET TË JENË FALAS PËR TË GJITHË STUDENTËT.

Pak kontekst: Sipas Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, universitetet publike financohen nga buxheti i shtetit, tarifatat e studentëve, tarifatat e shërbimeve të vendosura nga universiteti, kërkimi shkencor, etj. Fondi për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturës akademike nga buxheti i shtetit shpërndahet mbi bazën e renditjes së institucioneve publike të arsimit të lartë, të kryer nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor.

PRO

- Ofrimi i aksesit në arsimin e lartë publik pa pagesë për studentët do ta bënte arsimin e lartë më të përballueshëm për studentët.
- Ndjekja e arsimit të lartë pa pagesë do të ndikonte në rritjen e përqindjes së popullsisë me arsim të lartë në Shqipëri.
- Ndjekja e arsimit të lartë përmirëson mundësitë e studentëve të lartë për mundësi më të mira punësimi dhe të ardhura më të larta në të ardhmen.

KUNDËR

- Mundësimi i Arsimit të Lartë falas në Shqipëri është shumë i kushtueshëm, pasi kërkon që të rritet financimi i buxhetit të shtetit për arsimin e lartë.
- Shpenzimet më të mëdha të studentëve nuk janë tarifa e studimit, por shpenzimet e përditshme të jetespërditshme të jetesës. Heqja e tarifës nuk do ta rriste aksesin në arsimin e lartë.
- Arsimi i lartë falas nuk nënkupton arsim të lartë më cilësor.

BURIME:

- [Ligj_80-2015_22.07.2015.pdf \(unitir.edu.al\)](#)
- [Draft-Strategjia-per-Arsimin-2021-2026-1.pdf](#)
- [Kreu | Instat](#)
- [Education resources - Public spending on education - OECD Data](#)
- [16980.pdf \(fes.de\)](#)
- [Access to higher education: Introduction to the special issue - ScienceDirect](#)
- [The effects of tuition fees on transition from high school to university in Germany - ScienceDirect](#)
- [Financing higher education in an imperfect world - ScienceDirect](#)
- [National Education Systems | Eurydice \(europa.eu\)](#)
- [\(PDF\) Financing Public Universities: The Case of Performance Funding \(researchgate.net\)](#)
- [Countries with Free College Education: 49 Statistics You Should Know in 2023 - Financesonline.com](#)
- [Doktoratura-Ditjona-Kule-Fakulteti-Ekonomise-Departamenti-i-Ekonomiksit.pdf \(unitir.edu.al\)](#)

TAKSIMI I SHESHTË ËSHTË MODEL MË I PËRSHTATSHËM SE AI PROGRESIV PËR KONTEKSTIN SHQIPTAR.

Pak kontekst: Informaliteti në ekonomi është një nga sfidat kryesore për rritjen e të ardhurave në buxhetin e shtetit në Shqipëri. Mbështetësit e modelit të taksimit të sheshtë pretendojnë se taksimi në norma të ulëta dhe të njëjta për të gjithë popullsinë ekonomikisht aktive, ul motivimin e tyre për të qëndruar në ekonominë informale.

PRO

- Taksimi i sheshtë është më i thjeshtë për t'u aplikuar nga administrata tatimore dhe për t'u kuptuar nga njerëzit.
- Normat e ulëta të taksimit do t'a inkurajonin sektorin informal të formalizohet, duke rritur kështu të ardhurat në buxhetin e shtetit.
- Taksa e sheshtë nuk i ngarkon me barrë ekonomike ata që fitojnë më shumë dhe kështu, i inkurajon njerëzit të kryejnë më shumë aktivitet ekonomik pa frikën se do t'atohet më shumë.

KUNDËR

- Taksimi i sheshtë sjell më pak të ardhura në buxhetin e shtetit, krahasimisht me taksimin progresiv.
- Taksimi progresiv është më i drejtë, pasi takson më shumë ata që fitojnë më shumë dhe i lejon ata që paguhen më pak të kenë më shumë para në dispozicion.
- Ulja e informalitetit nuk lidhet me modelin e taksimit, por me nivelin e ndërgjegjësimit të njerëzve për interesin publik.

BURIME:

- <https://www.researchgate.net/search/publication?q=Flat+tax+in+Albania>
- Tatimi mbi të ardhurat personale (tatime.gov.al)
- (PDF) INFORMALITETI NE SHQIPERI | nerxhana tallushi - Academia.edu
- Struktura e të Ardhurave nga Puna | Instat
- Albania | Data (worldbank.org)
- Albania's Informal Economy Size | Shadow Economy | 2023 | Economic Data | World Economics
- wiiw Balkan Observatory Working Paper 94: The Effects of Flat Tax on Inequality and Informal Employment: The Case of Albania
- https://scholar.google.com/scholar_url?url=https://www.richtmann.org/journal/index.php/mjss/article/view/9677/9316&hl=en&sa=X&ei=JhDEY_zHNYiEmgGni6OwDg&scisig=AAGBfm2350liVvhtRhg_OiiFKro7XmVbdQ&oi=scholar

DIGJITALIZIMI I SEKTORIT PUBLIK DO TË ULË NIVELIN E KORRUPSIONIT NË VEND.

Pak kontekst: Shqipëria ka hedhur hapa drejt digjitalizimit të shërbimeve publike, si për shembull krijimi i portalit shtetëror e-albania, integrimi i identifikimit elektronik gjatë proceseve zgjedhore, pilotimi i votimit dhe numërimit elektronik, etj. Në vijim të këtyre masave, në maj të 2022 në Shqipëri u mbyllën sportelet fizike dhe dhënia e shërbimeve u transferua online.

PRO

- Digjitalizimi i sektorit publik ul kontaktin direkt mes qytetarit dhe nëpunësit publik dhe rrjedhimisht edhe shanset e korruptimit të zyrtarëve.
- Ofrimi i shërbimeve në mënyrë digjitale rrit cilësinë dhe eficiencën e shërbimeve, gjë që ul motivimin e qytetarëve për të dhënë para për një shërbim më cilësor dhe të shpejtë.
- Digjitalizimi i shërbimeve rrit transparencën dhe ul diskrecionin e nëpunësve publik, gjë që e vështirëson përfshirjen e tyre në akte korruptive dhe lehtëson kapjen e tyre në rast të kundërt.

KUNDËR

- Shqipëria ka nivel shumë të ulët të alfabetizimit digjital dhe është riskuar në mënyrë të vazhdueshme nga rrjedhja e të dhënave dhe sulmet kibernetike.
- Për shkak të kompetencave të pakta digjitale, mosha e mesme dhe mosha e tretë në Shqipëri do të jetë më e predispozuar të paguajë për të aksesuar shërbimin publik nga ofrues privatë.
- Digjitalizimi i shërbimeve do të hapë rrugë formave të tjera të korrupsionit, si blerja e të dhënave, dëmtimi i qëllimshëm pajisjeve dhe sistemeve, etj.

BURIME:

- [Digital Development Country Profile_Albania_final_02.22.pdf](#)
- [Transparency, Digitalization and Corruption | SpringerLink](#)
- [Public Administration Digitalization and Corruption in the EU Member States. A Comparative and Correlative Research Analysis | Androniceanu | Transylvanian Review of Administrative Sciences \(rtsa.ro\)](#)
- [Ndikimi_i_digjitalizimit_ne_sherbimet_publike.pdf \(asp.al\)](#)
- [Ofrimi me pagesë dhe vështirësitë në aksesimin e E-albania, deri tani asnjë masë kundër fenomenit - Faktoje.al](#)
- [E-Albania/95% e shërbimeve kaluan online, por qytetarët hasin probleme - Faktoje.al](#)
- [Digitalisation as an anti-corruption strategy: what are the integrity dividends of going digital? - Development Matters \(oecd-development-matters.org\)](#)
- [Revolucioni digjital, nga 1 Maji mbyllet sportelet fizike – Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit \(akshi.gov.al\)](#)

PËRDORIMI I INTELIGJENCËS ARTIFICIALE PËR SHKRIMIN E ARTIKUJVE SHKENCORË DUHET TË KONSIDEROHET PLAGJIATURË.

Pak kontekst: Përdorimi i inteligjencës artificiale ka filluar të shtrihet edhe në fushën e krijimit të teksteve, artikujve shkencorë dhe prezantimeve. Shembull ilustrues është krijimi i **ChatGPT** research edition nga Open AI. Mes antiplagjaristëve ka një debat të madh nëse shkrimi i prodhuar nga inteligjenca artificiale duhet të konsiderohet plagjiaturë apo jo. Ndërkohë po krijohen edhe mjete digjitale për dallimin e shkrimeve të krijuara me inteligjencë artificiale, si për shembull **Turnitin** apo **GPT-2 Output Detector Demo**.

PRO

- Nëse një artikull është shkruar prej inteligjencës artificiale, autorësia e tij nuk i takon më individit që ka përdorur teknologjinë për gjenerimin e artikujve, por aplikacionit.
- Pretendimi i autorësisë së një shkrimi/artikulli të përgatitur nga inteligjenca artificiale nuk është etik dhe konsiderohet mashtrim.
- Ekziston mundësia që edhe një artikull i shkruar me inteligjencë artificiale të përmbajë plagjiaturë, sipas kuptimit klasik të saj.

KUNDËR

- Shkrimet e prodhuara me inteligjencë artificiale kanë saktësi të lartë të citimit të burimeve, ndaj nuk mund të konsiderohen shkrime plagjiaturë.
- Gjenerimi i një shkrimi me ndihmën e inteligjencës artificiale kërkon përfshirjen e individit përdorues me përcaktimin e qartë të temës, fjalëve kyçe, linjës së tekstit dhe me raste edhe burimeve, ndaj artikulli ruan origjinalitetin e individit përdorues.
- Përdorimi i inteligjencës artificiale në artikuj redukton kohën e nevojshme për krijimin e një artikulli dhe rrit saktësinë e dokumentimit të burimeve. E përdorur si duhet ajo mund ta rrisë cilësinë e kërkimit shkencor.

BURIME:

- **How AI Will Change Authorship and Plagiarism - Plagiarism Today**
- **“Students are using AI to write their papers, because of course they are.” | Center for the Advancement of Teaching (temple.edu)**
- **AI is making it easier than ever for students to cheat. (slate.com)**
- **How to spot AI-generated text | MIT Technology Review**
- **Inter Research » ESEP » v21 » p17-23 (int-res.com)**
- **Should Using an AI Text Generator to Produce Academic Writing Be Plagiarism? by Brian L. Frye :: SSRN**
- **OpenAI**
- **Empower Students to Do Their Best, Original Work | Turnitin**

BINJAKËZIMET MES UNIVERSITETEVE SHQIPTARE DHE ATYRE EVROPIANE DO TË ULIN TRENDIN E LARGIMIT TË TË RINJVE NGA VENDI.

Pak kontekst: Një nga komponentët kryesore të Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2016-2026, ka të bëjë me ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë në Shqipëri. Për realizimin e këtij objekti, universitetet shqiptare inkurajohen të krijojnë programe të përbashkëta me universitete evropiane. Po ashtu qeveria shqiptare do të mbështesë IAL e huaja që duan të hapin degë/programe në Shqipëri.

PRO

- Programet e përbashkëta mes universiteteve shqiptare dhe atyre evropiane do t'u mundësojnë studentëve shqiptarë cilësi më të lartë arsimit dhe diploma të vlefshme në kontekst evropian, pa patur nevojë të largohen nga vendi.
- Studentët shqiptarë do të zgjidhnin të ndiqnin programet e përbashkëta të studimit nga Shqipëria, pasi kostot e jetesës dhe të tarifave universitare në Shqipëri janë më të ulëta se në Evropë, ndërohe që diploma në përfundim të studimit do të njihej njësoj.
- Procesi i ndërkombëtarizimit të universiteteve shqiptare, do të rriste prezencën e studentëve dhe profesorëve të huaj në vend, gjë që do t'u jepte mundësi studentëve shqiptarë ta përjetojnë diversitetin kulturor dhe akademik pa koston e largimit nga vendi.


KUNDËR

- Diploma evropiane dhe cilësia më e lartë e arsimit nuk janë motivet kryesore të largimit të të rinjve nga vendi. Pagat e ulëta, po.
- Pajisja e studentëve me diploma evropiane do ta thjeshtonte integrimin e tyre në tregun e punës evropian, gjë që do të rriste nivelin e emigrimit të të rinjve pas përfundimit të studimeve.
- Pavarësisht kostos më të ulët të jetesës, Shqipëria do ta kishte të vështirë të tërhiqte interesin e studentëve të huaj për shkak se ofron pak politika mbështetëse për studentët si dhe pak mundësi punësimi pas diplomimit.

BURIME:

- [Draft-Strategjia-per-Arsimin-2021-2026-1.pdf](#)
- [Kreu | Instat](#)
- [Ikja e të rinjve, fenomeni i largimit është më i lartë në Shqipëri, se kudo tjetër në Europë - Revista Monitor](#)
- [Pse të rinjtë duan të largohen nga Shqipëria? - Business Magazine Albania](#)
- [15271.pdf \(fes.de\)](#)
- [17259.pdf \(fes.de\)](#)
- [IPOL_STU\(2015\)540370_EN.pdf \(europa.eu\)](#)
- [Effects of an internationalization at home \(IAH\) programme on cultural awareness among medical and nursing students in Hong Kong and Indonesia during the COVID-19 pandemic: a mixed-methods study | BMC Medical Education | Full Text \(biomedcentral.com\)](#)
- [Impact of International Educational Migration in the Context of Globalization of Higher Education \(Case of Georgia\) \(tsu.ge\)](#)

Temat e debatit mes liderve



Debati mes liderve

1. Shqipëria duhet të investojë në lidhjet me diasporën dhe jo në politika për reduktimin e emigracionit në vend.
2. Universitetet shqiptare duhet të favorizojnë në renditje aplikantët e angazhuar në veprimtari vullnetare/komunitare.
3. Lëvizja e lirë në Bashkimin European për të jetuar, për t'u arsimuar dhe për të punuar do të shkaktojë krizë demografike në Shqipëri.

SHQIPËRIA DUHET TË INVESTOJË NË LIDHJET ME DIASPORËN DHE JO NË POLITIKA PËR REDUKTIMIN E EMIGRACIONIT NË VEND.

Pak kontekst: Niveli i lartë i emigrimit të shqiptarëve ndikon në plakjen e popullsisë dhe uljen e numrit të forcës punëtore në vend, gjë që sjell mungesë të punonjësve të kualifikuar në treg si dhe barrë më të rëndë ndaj buxhetit të shtetit dhe kontribuesve për mbulimin e pensioneve dhe sigurimeve shoqërore. Për adresimin e problematikës së emigracionit të lartë ekzistojnë disa qasje të ndryshme si strategjitë për parandalimin e emigracionit të lartë përmes politikave mbështetësve, strategjitë për thithjen e trurit, strategji për konsolidimin e lidhjeve me diasporën për të tërhequr më shumë investime dhe ekspertizë në në vend, etj.

PRO

- Shteti shqiptar nuk ka kapacitetet e duhura për të frenuar emigracionin dhe as për politika braingain, pasi nuk mund të konkurrojë me standardin e pagave në Evropë, SHBA, etj.
- Shqipëria ka një numër shumë të madh të diasporës, të cilin mund ta kthejë në avantazh për thithjen e fondeve, lobimin si dhe gjetjen e ekspertizës së nevojshme për nevojat e vendit.

KUNDËR

- Investimi në fuqizimin e bashkëpunimit mes shtetit shqiptar dhe diasporës kërkon shumë kohë dhe nuk i përgjigjet nevojave immediate për punonjës që kanë bizneset shqiptare.
- Shqipëria ka trupë diplomatike dhe resurse financiare shumë të kufizuara për të implementuar një strategji të tillë.

BURIME:

- **Diaspora në Shifra, 2020 | Instat**
- **Diaspora në Shifra, 2020 | Instat**
- **Albanian version.pdf (europa.eu)**
- **<https://albania.iom.int/sites/g/files/tmzbd1401/files/documents/mapping-and-profiling-of-albanian-diaspora.pdf>**
- **From-Brain-Gain-Policies-to-Practices-.pdf (crpm.org.mk)**
- **17259.pdf (fes.de)**
- **14924.pdf (fes.de)**
- **Microsoft Word - Brain drain_engl.doc (ceu.hu)**

UNIVERSITETET SHQIPTARE DUHET TË FAVORIZOJNË NË RENDITJE APLIKANTËT E ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI VULLNETARE/KOMUNITARE.

Pak kontekst: Në Shqipëri studentët me mesataren më të lartë renditen më lart në portal dhe kanë më shumë gjasa të pranohen në programin e studimit që dëshirojnë. Teza e mësipërme propozon që angazhimi vullnetar i aplikantëve të futet në kriteret e renditjes së aplikantëve në portal, në një masë që i favorizon aplikantët për t'u pranuar në programin që dëshirojnë, si një mënyrë për të mbështetur angazhimin e të rinjve në vullnetarizëm në vend.

PRO

- Futja e angazhimit vullnetar si kriter vlerësues për aplikantët do të rriste përfshirjen e të rinjve në aktivitete me bazë vullnetare në vend, gjë që plan afatgjatë do të përmirësonte pjesëmarrjen qytetare në vend.
- Futja e angazhimit vullnetar si kriter vlerësues për aplikantët do të rriste cilësinë e studentëve në universitetet shqiptare.
- Futja e angazhimit vullnetar si kriter vlerësues për aplikantët e afron praktikën shqiptare të përzgjedhjes së studentëve me praktikën e vendeve të tjera evropiane.

KUNDËR

- Kërkesa e krijuar për përvoja vullnetare do të ishte artificiale dhe do të nxiste fenomenin e lëshimit fiktiv të certifikatave dhe vërtetimeve për të rritur gjasat e aplikantëve për t'u përzgjedhur.
- Nxënësit jashtë Tiranës dhe në zona rurale kanë më pak mundësi se ata në kryeqytet për t'u përfshirë në aktivitete me bazë vullnetare. Futja e këtij kriteri do të ulte gjasat e aplikantëve nga këto zona për të ndjekur arsimin e lartë.
- Futja e angazhimit vullnetar si kriter vlerësues për aplikantët në universitet do të komplikonte shumë procesin e përzgjedhjes së aplikantëve për shkak të nevojës për të verifikuar vërtetësinë e certifikatave të akorduara në emër të studentit.

BURIME:

- **Study in Europe: Country profiles | European Education Area (europa.eu)**
- **Ligj_80-2015_22.07.2015.pdf (unitir.edu.al)**
- **ligj-2016-04-28-45.pdf (resourcecentre.al)**
- **Volunteer Activities for College Applications – Connections Academy®**
- **Full article: How do universities recognise student volunteering? A symbolic interactionist perspective on the recognition of student engagement in higher education (tandfonline.com)**
- **Booklet of recommendations in favour of student engagement and its recognition in Europe (uni-foundation.eu)**
- **Community Service in the Transition: Shifts and Continuities in Participation from High School to College: The Journal of Higher Education: Vol 75, No 3 (tandfonline.com)**
- **(PDF) A Cross-Cultural Examination of Student Volunteering: Is It All About Resume Building? (researchgate.net)**

LËVIZJA E LIRË NË BASHKIMIN EUROPIAN PËR TË JETUAR, PËR T'U ARSIMUAR DHE PËR TË PUNUAR DO TË SHKAKTOJË KRIZË DEMOGRAFIKE NË SHQIPËRI.

Pak kontekst: Lëvizja e lirë e njerëzve, mallrave dhe shërbimeve është një nga shtyllat e Bashkimit Evropian, ku Shqipëria synon të anëtarësohet. Teza e parashtruar propozon se trendi i emigrimit të shqiptarëve nga vendi do të theksohet edhe më shumë pasi Shqipëria të jetë anëtarësuar në BE.

PRO

- Anëtarësimi i Shqipërisë në BE do t'ua bëjë shqiptarëve më të lehtë zhvendosjen në vendet e tjera të Bashkimit Evropian, ku pagat dhe standarti i jetesës është më i lartë.
- Anëtarësimi i Shqipërisë në BE do të zgjeronte tregun e punësimit për profesionistët shqiptarë, gjë që do ta thellonte fenomenin e largimit të trurit nga vendi.
- Lehtësia e lëvizjes dhe pagat konkurruese në tregun evropian, do të thellonin fenomenin e ikjes së të rinjve nga vendi, gjë që do të përkthehej në rritje të trendit të plakjes së popullsisë dhe në kufizimin e kontribuesve në skemat e sigurimeve shoqërore në vend.

KUNDËR

- Kostot më të ulëta të jetesës dhe lehtësia e zhvendosjes në Shqipërinë e anëtarësuar në Bashkimin Evropian, do të tërhiqnin imigrantë në Shqipëri. Shqipëria do të bëhej më multikulturore, por nuk do të shpopullohej.
- Zhvillimet teknologjike do të shtojnë tregun e punësimit remote në Evropë, gjë që do ti lejojë shtetasve shqiptarë të integrohen në tregun evropian të punësimit pa patur nevojë të largohen nga vendi.
- Rritja e aksesit në fonde zhvillimore nga BE si rezultat i anëtarësimit në BE do të përmirësonte situatën ekonomike në vend, gjë që do të ulte motivimin për t'u larguar nga vendi.

BURIME:

- **Projeksionet | Instat**
- **26f0dc16-4a08-2707-f8d5-8b1b84794169 (europa.eu)**
- **Migration and migrant population statistics - Statistics Explained (europa.eu)**
- **sfidat_demografike_shendetesore_report_2020_albanian_version_0.pdf (unfpa.org)**
- **Dynamics and determinants of emigration: the case of Croatia and the experience of new EU member states :: Public Sector Economics (pse-journal.hr)**
- **Rise in EU population working from home - Products Eurostat News - Eurostat (europa.eu)**
- **Current trends in remote working (assets.kpmg)**



SUKSESE!